HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
BORDI I DREJTORËVE

Nr. I/73
Datë: 30.04.2024

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke pasur parasysh Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për NP, Nenin 162 të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, Nenin 15 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Nenin 15.2.3 të Statutit Nr. I/02 të dt. 19.01.2024 të HK-Trainkos Sh.A, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A, në Mbledhjen Nr. 07, të mbajtur më 30.04.2024, njëzëri mori këtë:

VENDIM

I. **Z. Burim Bylygbashi** emërohet në pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit në HK-Trainkos Sh.A.
II. I njëjti detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i kryejë në përputhje me legjislacionin në fuqi për NP-të në Kosovë, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative, Statutin dhe rregulloret tjera të HK-Trainkos Sh.A.
III. Kompensimi për kryerjen e kësaj detyre do të bëhet në bazë të Kategorizimit të Pagave në HK-Trainkos Sh.A.
IV. Të drejtat dhe obligimet tjera nga marrëdhënia e punës rregullohen me kontratën e punës.
V. Vendimi hyn në fuqi nga data 07.05.2024.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit sipas Konkursit publik të datës 15.03.2024, duke u bazuar në vlerësimin maksimal nga procedura e intervistimit të kandidatëve në këtë Konkurs, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Ankesa kundër këtij vendimi mund të drejtohet në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA - Kryesues

Iu dërgohet:
- Z. Burim Bylygbashi
- Kryeshefit Ekzekutiv
- Aksionarit – NJPMNP
- Departamentit të Administratës
- Arkivit